

Kushtet dhe Termat – Fushata “Refero një mik”

1. Organizatori i fushatës

Fushata “Refero një mik” organizohet nga iute dhe u drejtohet klientëve ekzistues të iute, sipas kriterëve të përcaktuara në këto Kushte dhe Terma.

2. Periudha e fushatës

Fushata është e vlefshme deri më 30 shtator 2026, përfshirë këtë datë.

Për të përfituar nga shpërblimi, referimi, krijimi dhe aktivizimi i llogarisë në Myiute nga miku i referuar, si dhe transaksioni i vlefshëm i përcaktuar në pikën 5 më poshtë, duhet të kryhen brenda periudhës së fushatës.

3. Kush mund të referojë

Në fushatë mund të marrin pjesë klientët ekzistues të iute, të përfshirë në grupet e klientëve të përcaktuara nga iute për këtë fushatë dhe që kanë të disponueshëm funksionalitetin “Refero një mik” në Myiute App.

Klienti ekzistues mund të referojë një mik duke përdorur linkun e tij personal të referimit, të gjeneruar në Myiute App.

Linku personal i referimit mund të aksesohet duke ndjekur hapat:

Myiute App → Homepage → Emri/Profili → “Refero një mik” → Ndaj linkun personal të referimit.

Linku personal i referimit duhet t’u dërgohet personave që nuk kanë qenë më parë klientë të iute.

Nuk ka kufizim në numrin e referimeve të vlefshme që mund të realizojë një klient gjatë periudhës së fushatës, përveç rasteve të parashikuara në pikën 9 të këtyre Kushteve dhe Termave.

Punonjësit e iute dhe personat e përfshirë në administrimin e kësaj fushate nuk kualifikohen për përfitimin e shpërblimit.

4. Kush mund të jetë mik i referuar

Për t’u kualifikuar për fushatën, miku i referuar duhet të jetë klient i ri në iute dhe të mos ketë qenë më parë klient i iute.

Për qëllimet e kësaj fushate, “klient i ri” konsiderohet vetëm personi që nuk ka pasur më parë marrëdhënie kontraktore me iute, sipas të dhënave të disponueshme në sistemet e iute.

Miku i referuar duhet të përdorë linkun personal të referimit të marrë nga klienti ekzistues për të krijuar dhe aktivizuar llogarinë e tij në Myiute.

Nëse personi i referuar ka qenë më parë klient i iute ose nuk e krijon dhe aktivizon llogarinë përmes linkut personal të referimit, referimi nuk konsiderohet i vlefshëm për qëllimet e kësaj fushate.

5. Kushtet për përfitimin e shpërblimit

Për t'u kualifikuar për shpërblimin, deri më 30 shtator 2026, miku i referuar duhet:

1. Të përdorë linkun personal të referimit për të krijuar dhe aktivizuar llogarinë e tij në Myiute; dhe
2. Të kryejë me sukses të paktën një nga transaksionet e mëposhtme:
 - të marrë një kredi cash përmes Myiute App ose iute.al;
 - të kryejë një blerje me këste në rrjetin e partnerëve iute;
 - të blejë siguracionin e makinës në Myiute App; ose
 - të kryejë një blerje në iuteMarket, platforma e blerjeve brenda Myiute App.

Transaksioni duhet të jetë kryer me sukses dhe të jetë regjistruar në sistemet e iute brenda periudhës së fushatës.

6. Shpërblimi

Për çdo referim që plotëson me sukses të gjitha kushtet e përcaktuara në këto Kushte dhe Terma:

- Klienti ekzistues që ka bërë referimin përfiton 3,000 Lekë;
- Miku i referuar përfiton 3,000 Lekë.

Për çdo referim të vlefshëm, shpërblimi total është 6,000 Lekë, i ndarë në mënyrë të barabartë ndërmjet klientit ekzistues që ka bërë referimin dhe mikut të referuar.

Çdo detyrim fiskal që mund të lindë nga përfitimi i shpërblimit do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Kreditimi i shpërblimit

Shuma prej 3,000 Lekësh do të kreditohet në llogarinë Myiute të secilit përfitues brenda 15 ditëve kalendarike nga data e verifikimit të përmbushjes së të gjitha kushteve të fushatës.

Kreditimi i shpërblimit kryhet pasi iute të ketë verifikuar përmbushjen e të gjitha kushteve të fushatës, vlefshmërinë e referimit dhe kryerjen me sukses të transaksionit përkatës.

8. Vlefshmëria e referimit

Një referim konsiderohet i vlefshëm vetëm nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

- referuesi është klient ekzistues i iute dhe është i përfshirë në fushatë;

- personi i referuar është klient i ri dhe nuk ka qenë më parë klient i iute;
- miku përdor linkun personal të referimit për krijimin dhe aktivizimin e llogarisë së tij në Myiute;
- krijimi dhe aktivizimi i llogarisë kryhen deri më 30 shtator 2026;
- miku kryen me sukses të paktën një nga transaksionet e përcaktuara në pikën 5 deri më 30 shtator 2026.

Nëse një ose më shumë prej kushteve të mësipërme nuk plotësohen, referimi nuk kualifikohet për shpërblim.

9. Verifikimi dhe përjashtimi nga fushata

iute rezervon të drejtën të verifikojë përmbushjen e kushteve të fushatës përpara kreditimit të shpërblimit.

Referimet ose transaksionet që rezultojnë të pasakta, të paplota, të dyfishta, të manipuluar, të kryera në kundërshtim me këto Kushte dhe Terma ose për të cilat ekzistojnë dyshime të arsyeshme për abuzim me mekanizmin e fushatës, mund të përjashtohen nga përfitimi i shpërblimit.

Në këto raste, iute rezervon të drejtën të mos kreditojë shpërblimin për klientin referues dhe/ose mikun e referuar.

10. Kushtet për produktet dhe shërbimet

Për produktet dhe shërbimet e përfshira në fushatë zbatohen gjithashtu kushtet, kriteret e pranueshmërisë dhe kërkesat përkatëse të secilit produkt ose shërbim.

Dhënia e një kredie ose financimi është subjekt i vlerësimit dhe miratimit sipas politikave të kreditimit të iute. Pjesëmarrja në fushatë ose marrja e një linku referimi nuk garanton miratimin e një aplikimi për kredi ose financim.

11. Kushtet e përgjithshme

Pjesëmarrja në fushatë nënkupton pranimin e këtyre Kushteve dhe Termave.

iute rezervon të drejtën të ndryshojë, pezullojë ose përfundojë fushatën, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Çdo ndryshim i Kushteve dhe Termave do të komunikohet nëpërmjet kanaleve përkatëse të iute.

Në rast të mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në këto Kushte dhe Terma, pjesëmarrësit nuk kanë të drejtë të përfitojnë shpërblimin e fushatës.

12. Përpunimi i të dhënave personale

Të dhënat personale të pjesëmarrësve do të përpunohen nga iute në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Politikën e Privatësisë së

iute. Të dhënat do të përdoren për administrimin e kësaj fushate, verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kreditimin e shpërblimit.